



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0450

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE N.SH.T. VIKTORY COM, kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Meqe” me numër të prokurimit 632-24-2484-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës, më 19/08/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik OE “N.Sh.T. Viktory Com” me nr. 2024/450, e datës, 24/05/2024, kundër vendimit të AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve ne fshatin Meqe” me nr. të prokurimit: "632-24-2484-5-2-1" inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës.

2. Mbetet në fuqi “Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues” datës, 13.05.2024, i Autoritetit Kontraktues, Komuna e Gjakovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në piken 1. të këtij vendimi.

3. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës ndaj e Operatorit Ekonomik OE “N.Sh.T. Viktory Com”, konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 19.03.2024 Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Meqe” me nr. të prokurimit: "632-24-2484-5-2-1". Ndërsa me datë 13.05.2024 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE “REA SHPK- Abedin Rexha”- Klinë.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 152,262.22€.

Me 15.05.2024 OE “N.Sh.T. Viktory Com” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 20.05.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 24.05.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “N.Sh.T. Viktory Com” me nr. 450/2024 lidhur me aktivitetin “Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve ne fshatin Meqe” me nr. të prokurimit: "632-24-2484-5-2-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “N.Sh.T. Viktory Com” janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) : “OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, ka parashtruar ankese ne OSHP me pretendimin se autoriteti kontraktues nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të LPP-së. Autoriteti kontraktues pas përfundimit te vlerësimit te ofertave e ka njoftuar OE ankues me letrën standarde te tenderuesit te eliminuar, ne te cilën i ka numëruar arsyet e eliminimit: OE ankues eliminohet nga AK-ja, me arsyetimin se, ju si operator ekonomik nuk keni prezantuar marrëveshje për baze te asfaltit, por keni dorëzuar vetëm licencë ne emrin e OE Premium Bau SHPK kërkesë eliminuese e FDT. Ju si operator ekonomik nuk keni prezantuar Marrëveshje për Gurthyes por keni prezantuar vetëm licencë për gurë te fort dhe për shkëmb guri i forte ne emër te OE Nëntë vëllezërit. “

Pretendimi i dytë (II) : “Operatori ankues pretendon se i rekomanduari për kontratë është i papërgjegjshëm pasi qe ne dokumentet e REA ShPK si dëshmi është paraqitur marrëveshja me kompaninë Vctorya Invest për finisher Bitell B672. Sipas OE ankues, operatori i rekomanduar ka paraqitur një Dud doganor për makinerinë e përdorur për hedhjen e asfaltit tipi BB30 dhe pesha e tij është 6.800kg dhe ne baze te peshës dhe tipit ky është mini finisher ku në bazë te dimensioneve ky finisher nuk mund të përdoret për këto projekte pasi qe sipas dimensioneve minimumi është 1.7 metra dhe maksimumi 3.1 metër.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE “N.Sh.T. Viktory Com” konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 56, 60, 69 LPP-së si dhe neni 37 i RrPP-së. Kërkojmë nga OSHP-ja që të aprovohet kjo Ankesë e jonë, duke u bazuar ne fakte dhe argumente te paraqitura ne Ankese.

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim:

“Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 20.05.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë: Pretendimi juaj i parë nuk qëndron, sepse dokumentet që ju pretendoni se është

dashur Autoriteti kontraktues të ju kërkoj në bazë të nenit 72 të LPP-së, janë dokumente që mund të prodhohen. Marrëveshja për furnizim me asfalt, e prezantuar nga ju, ka edhe një problem sepse tek noterizimi ka mospërputhje të datave - marrëveshja është e lidhur me dt. 12.04.2024, kurse ju jeni paraqitur te noteri (keni noterizuar) marrëveshjen me dt. 11.04.2024, pra noterizimi është bërë një ditë para lidhjes së marrëveshjes. Me këtë është konfirmuar pretendimi ynë se ky dokument nuk duhet të kërkohet. Pretendimi juaj i dytë lidhur me finisherin, gjithashtu është i pabazuar, sepse Autoriteti kontraktues në kërkesën e tij në FDT-ë, nuk ka caktuar se çfarë peshe duhet të ketë finisheri, por vetëm është kërkuar finisher, të cilën kërkesë c ka plotësuar Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv. ”

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 24/05/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 450/2024, ndërsa me datë 07/06/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/450 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, po ashtu edhe OE Nuk Pajtohet lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Lidhur me pretendimet e OE “N.Sh.T. Viktory Com” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/450 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): “Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë arsytim te AK-se, sqaron se AK-ja ne dosje te tenderit ka kërkuar: Operatori Ekonomik duhet te këtë Bazë për asfalt nga një kompani e licencuar ose marrëveshje për furnizim Gurëthyes ose separacion të licencuar ose marrëveshje për furnizim. Kopjet e licencave te vlefshme te lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale. Vërejtje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licencat e Operatorit Ekonomik. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësi dhe qiradhënësit. Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues ne ofertën e tij ka dorëzua: “Licencën e shfrytëzimi”, “Lejen për aktivitete te veçanta” si dhe “Licencën për shfrytëzim”. Ne vlerësim të Eksperti shqyrtues, OE ankues nuk e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit për faktin se autoriteti kontraktues te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ka kërkuar që Operatori Ekonomik duhet te këtë Bazë për asfalt nga një kompani e licencuar ose marrëveshje për furnizim Gurëthyes ose separacion të licencuar ose marrëveshje për furnizim. Ndërsa OE ankues ne ofertën e tij nuk ka dorëzuar marrëveshje për baze te asfaltit, por ka dorëzuar vetëm licencë ne emrin e OE Premium Bau SHPK si dhe nuk ka prezantuar Marrëveshje për Gurthyes por ka prezantuar vetëm licencë për gurë te fort dhe për shkëmb guri i forte ne emër te OE Nëntë vëllezërit. Pra, dy arsyet e eliminimit te OE ankues, nga ana e autoritetit kontraktues qëndrojnë.”

Konstatimi i dytë (II) : “Eksperti shqyrtues, sqaron se lidhur me këtë pretendim, sqaron se AK-ja në dosje të tenderit te aneksi 7, ka kërkuar: Finisher I. Eksperti shqyrtues, sqaron se pretendimi i OE ankues nuk qëndron për faktin se i rekomanduar për kontrate e plotëson kërkesës e dosjes se tenderit sipas aneksit 7 të DT dhe njoftimit për kontrate. AK-ja ne kërkesës e dosjes e tenderit nuk ka përcaktuar peshën e finisherit, por vetëm është kërkuar pajisja finisher te cilën operatori i

rekomanduar për kontrate e ka plotësuar me dëshminë e dorëzuar.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritot.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, OE “N.Sh.T. Viktory Com” raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit të gjitha pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik “N.Sh.T. Viktory Com” janë konstatuar si të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik “N.Sh.T. Viktory Com” duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Gjakovës lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi-asfaltimi i rrugëve në fshatin Meqe” me nr. të prokurimit: "632-24-2484-5-2-1".

Paneli duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankese të OE "N.Sh.T. Viktory Com", vendosi të konfiskohen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - N.SH.T. VIKTORY COM**
- Arkivës së OSHP-së: